



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.180/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesuese, Afijete Sada-Gillogjani dhe Ymer Hoxha anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KDTP) dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterave në shtyll elektrike në komunën e Prizrenit, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 12.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohet** si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP) dega në Prizren, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 450.00 (katërqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

### A r s y e t i m

Me datën 10.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankes nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 08.10.2017 në rrugën Lidhja Shqiptare në Prizren kanë hasur të vendosur në shtyll elektrike posterin e kandidatit për asamble komunale Furkan Erguler nga subjekti politik KDTP. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës 13/2014, si dhe nenit 33 pika b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastet në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 12.10.2017, subjekti politik KDTP, thekson se pas pranimit të ankesës nr. ZL.Anr.81/2017 kanë ndërrmar masat paraprake për heqjen e posterave, ashtu që me datë 10.10.2017 nuk i kanë pasur posterët në vendet e përmendura në ankesë. Për të mbështetur pretendimet ankimore, ka bashkangjitur disa fotografi të printuara në vendet ku i kanë hjekur posterat.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri I kandidatit të subjektit politik KDTP Furkan Erguler është vendosur në shtyll elektrike gjegjësisht në objekt publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve dhe slloganeve, në objekte publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik KDTP, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri I kandidatit nga ky subjekt politik, është vendosur në objekt publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik KDTP, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se e njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre për shkeljen e supozuar, pretendimet në ankesë nga ana e panelit janë vlerësuar si pa ndikim në marrjen e vendimit më të favorshëm për subjektin në fjalë. Ndërsa, veprime që kanë ndërmarrë për të bërë përmirësimin e shkeljes nga Paneli janë vlerësuar pozitivisht dhe me ndikim në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi. Paneli po ashtu vlerësoi dënimin i shqiptuar ndaj subjektit në fjalë do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL. Anr.180/2017 më datën 12.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Fejzullah Rexhepi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.